

LIGJ

Nr. 8911, date 6.6.2002

PER RATIFIKIMIN E KONVENTES NR.178 "INSPEKTIMI I PUNES (DETARET),  
1996" TE ORGANIZATES NDERKOMBETARE TE PUNES

Ne mbeshtetje te neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 te Kushtetutes, me propozimin  
e Keshillit te Ministrave ,

KUVENDI I

REPUBLIKE SE SHQIPERISE

VENDOSI

Neni 1

Ratifikohet Konventa nr .178 "Inspektimi i Punes (Detaret), 1996" te Organizates  
Nderkombetare te Punes.

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3377, date 24.6.2002 te Presidentit te Republikes se Shqiperise,  
Rexhep Meidani

KONVENTA Nr. 178

KONVENTA LIDHUR ME INSPEKTIMIN E KUSHTEVE TE PUNES DHE JETES  
SE NJEREZVE TE DETIT (DETARET)

Konferenca e pergjithshme e Organizates Nderkombetare te Punes, e thirrur ne Gjeneve  
nga Keshilli Administrativ i Zyres Nderkombetare te Punes, dhe e mbledhur me 8 tetor  
1996, ne sesionin e saj te 84-te,

Duke pare ndryshimet e ndodhura ne natyren e sektorit detar dhe ndryshimet qe  
rezultojne per kushtet e punes dhe jetes se detareve qe nga koha kur rekomandimi mbi  
inspektimin e punes (detaret), 1926 ka qene miratuar ,

Duke sjelle ne kujtese dispozitat e Konventes dhe rekomandimit mbi Inspektimin e  
Punes, 1947, te rekomandimit te inspektimit te punes (miniera dhe transporti), 1947, dhe  
te Konventes mbi Marinen Tregtare (norma minimale), 1976,

Duke kujtuar hyrjen ne fuqi, me 16 nentor 1994, te Konventes te Kombeve te Bashkuara  
mbi te drejten e detit, 1982,

Pasi vendosi te miratoje propozime te ndryshme lidhur me rishikimin e rekomandimit mbi inspektimin e punes (detaret), 1926, geshtje qe perben piken e pare te rendit te dites te sesionit;

Pasi vendosi qe keto propozime te marrin formen e nje konvente nderkombetare te zbatueshme

vetem ndaj Shtetit qe perfaqeson flamuri,

Miraton, ne ditën e 22 tetorit 1996, konventen e meposhtme, e cila do te quhet Konventa mbi Inspektimin e Punes (njerezit e detit/detaret), 1996.

## PJESA I. FUSHA E ZBATIMIT DHE PERKUFIZIME

### Neni 1

1. Me kusht te dispozitave te kunderta qe figurojne ne kete nen, kjo Konvente zbatohet ndaj çdo anije te regjistruar ne territorin e nje Anetari, per te cilin Konventa eshte ne fuqi, prone shteterore ose private, e caktuar per qellime tregtare, transportin e mallrave apo pasagjereve ose e perdor per qellime re tjera tregtare. per qellime te Konventes, nje anije e regjistruar ne territorin e dy Anetareve konsiderohet si e regjistruar ne territorin e atij, flamurin e te cilit valevit.

2. Legjislacioni kombetar do te percaktoje se cilat anije do te quhen anije te detit per qellime te kesaj Konvente.

3. Kjo Konvente zbatohet ndaj rimorkiatureve te detit. Kjo Konvente nuk zbatohet ndaj anijeve me tonazh bruto me te vogel se 500 , as ndaj anijeve te tilla si platforma shpimi dhe shfrytezimi kur ato nuk perdoren per lundrim. I takon organit qendror te koordinimit te vendose, ne konsulte me organizatat me te perfaqesuara te armatoreve dhe te detareve, se cilat jane anijet e parashikuara nga ky paragraf.

5. per sa qe organi qendror i koordinimit do ta gjykoje te realizueshme, pas konsultimesh me organizatat e perfaqesuara te armatoreve te peshkimit dhe peshkatareve, dispozitat e kesaj Konvente do te zbatohen ndaj anijeve te peshkimit detar tregtar .

6. Ne rast dyshimi mbi çeshtjen per te ditur nese nje anije do te konsiderohet si e destinuar per shfrytezim detar tregtar ose per peshkim detar tregtar per qellime te kesaj Konvente, çeshtja do te rregullohet nga organi qendror i koordinimit, pas konsultimesh me organizatat e armatoreve, te detareve dhe peshkatareve te interesuar .

7. Per qellime te kesaj Konvente:

a) shprehja "organ qendror i koordinimit" tregon ministrat, sherbimet qeveritare ose te gjitha organet e tjera shteterore me aftesine ligjore te shpalljes se vendimeve, rregulloreve ose udhezimeve te detyrueshme per inspektimin e kushteve te punes dhe jeteses se detareve, qe kane te bejne me çdo anije te regjistruar ne territorin e Anetarit dhe te mbikeqyre zbatimin e saj;

b) termi "inspektor" tregon çdo funksionar ose nje tjeter agjent shteteror i ngarkuar te inspektoj çdo aspekt te kushteve te punes dhe jeteses se detareve, si dhe çdo person tjeter te pajisur me dokumentet e duhura, qe kryen inspektime te tilla per llogari te nje institucioni apo nje organizate, i autorizuar nga organi qendror i koordinimit, ne perputhje me dispozitat e nenit 2 paragrafi 3 ;

- c) shprehja "dispozita ligjore" mbulon, pervec legjislacionit kombetar, sentencat e arbitrazhit dhe kontratat kolektive te detyrueshme;
- d) shprehja "njerezit e detit (dertaret)" tregon personat e punesuar, ne çfaredo cilesie, ne nje anije detare mbi te cilen zbatohet Konventa. Ne rast dyshimi mbi kategorite e personave qe duhet te konsiderohen si detare, per qellime te kesaj Konvente, çeshtja do te rregullohet nga organi qendror i koordinimit, pas konsultimesh me organizatat e armatoreve dhe detareve te interesuar;
- e) shprehja "kushtet e punes dhe jeteses se detareve" tregon kushtet, te tilla si ato qe kane te bejne me mirembajtjen dhe pastertine e vendit, jetes dhe punes ne bord, moshen minimale, kontratat e angazhimit, ushqimin dhe sherbimin ne tavoline, strehimin e ekuipazhit, rekrutimin, efektivat, kualifikimet, kohezgjatjen ne pune, vizitat mjekesore, parandalimin e aksidenteve ne pune, perkujdesjet mjekesore, pagesat per semundje dhe aksidente, mireqenien dhe çeshtje te lidhura me te, riatdhesimin, dhe lirine sindikale, ashtu siç eshte percaktuar ne Konvenen mbi Lirite Sindikale dhe mbrojtja e te drejtes sindikale, 1948, te Organizates Nderkombetare te Punes.

## PJESA II. ORGANIZIMI I INSPEKTIMIT

### Neni 2

1. Çdo Anetar, ndaj te cilit zbatohet Konventa, do te siguroje nje sistem inspektimi te kushteve te punes dhe te jeteses se detareve.
2. Organi qendror i koordinimit do te koordinoje teresisht ose pjeserisht inspektimet qe i kushtohen kushteve te punes dhe jeteses se detareve dhe do te hartoje parime qe duhen respektuar .
3. Organi qendror i koordinimit do te marre, ne te gjitha rastet, pergjegjesine e inspektimit te kushteve te punes dhe jeteses se detareve. Ai do te mund te autorizojë institucionet shtetërore ose organizata te tjera, te cilave u njeh kompetencen dhe pavaresine per te proceduar ne emer te tij per nje inspektim te tille. Ai duhet ta mbaje aktuale dhe ta vere ne dispozicion te publikut nje liste te ketyre institucioneve apo organizmave.

### Neni 3

1. Çdo Anetar do te kujdeset qe te gjitha anijet e regjistruara ne territorin e tij te inspektohen ne intervale qe nuk i kalojne tre vjetet dhe, kur kjo eshte e realizueshme çdo vit, me qellim qe te verifikohet se kushtet e punes dhe jeteses ne bord jane ne perputhje me legjislacionin kombetar .
2. Nese nje Anetar merr nje ankim ose fiton nje prove se nje anije e regjistruar ne territorin e tij nuk perputhet me legjislacionin kombetar, persa u perket kushteve te punes dhe jeteses se detareve, Anetari do te duhet te marre masat per te proceduar ne inspektimin e anijes sapo kjo te jete e realizueshme.
3. Ne rastin e ndryshimeve te rendesishme te bera ne konstruksionin apo rregullimin e anijes, do te procedohet ne inspektimin e saj brenda tre muajve pas ketyre ndryshimeve.

### Neni 4

C;do Anetar do te duhet te caktoje inspektore te kualifikuar per te ushtruar funksionet qe u jane ngarkuar dhe te marrin masat e nevojshme per t'u siguruar se jane ne numer te mjaftueshem per t'iu pergjigjur kerkesave te kesaj Konvente.

#### Neni 5

1. Statuti dhe kushtet e sherbimit te inspektoreve do te duhet t'i beje ata te pavarur nga çdo ndryshim i qeverise dhe influence e jashtme e padrejte.
2. Inspektoret, te pajisur me dokumente qe perligjin funksionet e tyre, jane te autorizuar:
  - a) te ngjiten ne bordin e anijes te regjistruar ne territorin e Anetarit dhe te futen ne lokale per qellime inspektorni;
  - b) te procedoje ne shqyrtime, kontrole ose anketa qe ata i gjykojne te nevojshme per t'u siguruar se dispozitat ligjore respektohet ne menyre te rrepte;
  - c) te kerkojne qe te riparohen mangesite;
  - d) te ndalojne, me kushtin e te drejtes per t'iu drejtuar organit administrativ apo gjyqesor, qe nje anije te lere portin, deri sa te merren masat e nevojshme, kur ata kane arsye te besojne se nje mangesi perben nje rrezik te rendesishem per shendetin dhe sigurine e detareve, anija nuk duhet te ndalohet ose te vonohet pa te drejte.

#### Neni 6

1. Kur do te procedohet ne nje inspektim ose kur masat do te jene marre ne perputhje me dispozitat e kesaj Konvente, te gjitha perpjekjet e arsyeshme duhet te behen per te evituar qe anija te mbahet ose vonohet me te padrejte.
2. Armatori ose shfrytezuesi i anijes mund te pretendoje per nje kompensim per çdo demtim ose humbje qe do te rezultonte nga ndonje lloj ndalimi apo vonese e padrejte, duke marre persiper barren e proves.

### PJESA III. SANKSIONET

#### Neni 7

1. Do te duhet te parashikohen nga legjislacioni kombetar dhe te zbatohen me efektivitet sanksionet e duhura per shkelje te dispozitave ligjore, zbatimi i te cilave u takon inspektoreve dhe per pengimin qe u behet inspektoreve ne ushtrimin e funksionit te tyre.
2. Inspektoret do te kene te drejte te japin paralajmerime dhe keshilla, ne vend qe te ngrene padi apo te rekomandojne ndjekje ligjore.

### PJESA IV. RAPORTET

#### Neni 8

1. Organi qendror i koordinimit do te mbaje regjistrat e inspektimeve te kushteve te punes dhe jeteses se detareve.

2. Ai do te publikoje nje raport vjetor mbi veprimtarine e inspektimit, duke perfshire nje liste te institucioneve dhe organizatave te autorizuar te procedojne ne inspektime ne emer te tij. Ky raport do te publikohet ne nje afat te arsyeshem, duke mos tejkaluar ne asnje rast gjashte muaj, duke u nisur nga fundi i vitit te cilit i referohet.

Neni 9

1. Inspektoret duhet, per çdo inspektim te kryer, t' i paraqesin nje raport organit qendror te koordinimit. Nje kopje e ketij raporti ne gjuhen angleze ose ne gjuhen e punes se anijes do t'i dorezohet kapitenit, nje tjetër do te afishohet ne nje table afishimi te anijes per informacion te detareve ne bord ose t'u komunikohet perfaqesuesve te tyre.

2. Ne rastin e nje inspektimi te bere si pasoje e nje incidenti madhor, raporti do te duhet te paraqitet sa me shpejt qe te jete e mundur dhe jo me vone se nje muaj pas konkluzioneve te inspektimit.

## PJESA V. DISPOZITAT FINALE

Neni 10

Kjo Konvente zevendeson Rekomandimin mbi Inspektimin ne Pune (detaret), 1926.

Neni 11

Ratifikimet zyrtare te kesaj Konvente do t'i komunikohen Drejtorit te pergjithshem te lyres Nderkombetare te Punes dhe do te regjistroheshen prej tij.

Neni 12

1. Kjo Konvente do te lidhe vetem Anetaret e Organizates Nderkombetare te Punes, ratifikimi i se ciles do te jete regjistruar nga Drejtori i pergjithshem i Zyres Nderkombetare te Punes.

2. Ajo do te hyje ne fuqi dymbedhete muaj pasi ratifikimet e dy Anetareve do te jene regjistruar nga Drejtori i pergjithshem.

3. Me pas, kjo Konvente do te hyje ne fuqi per çdo Anetar, dymbedhete muaj pas dates ne te cilen do te jete regjistruar ratifikimi i saj .

Neni 13

1. Çdo Anetar, qe ka ratifikuar kete Konvente, mund ta denoncoje ne mbarim te nje periudhe dhjetevjecare pas dates se hyrjes fillestare ne fuqi te Konventes, me ane te nje akti qe i komunikohet Drejtorit te pergjithshem dhe regjistrohet prej tij. Denoncimi merr fuqi vetem pas nje viti nga regjistrimi i tij.

2. Çdo Anetar, qe ka ratifikuar kete Konvente, i cili, ne afatin e nje viti pas mbarimit te periudhes dhjetevjecare, te permendur ne paragrafim e mesiperme, nuk do te perdore te drejten e denoncimit te parashikuar nga ky nen, do te lidhet per nje periudhe te re

dhjetevjecare, dhe, ne vazhdim do te mund ta denoncoje kete konvente ne mbarim te cdo periudhe dhjetevjecare ne kushtet e parashikuara nga ky nen.

#### Neni 14

1. Drejtori i pergjithshem i Zyres nderkombetare te Punes do t'iu komunikojte te gjitha Anetareve te Organizates Nderkombetare te punes regjistrimin e te gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve, te cilat do t' i komunikohen nga Anetaret e Organizates .  
Duke iu njoftuar Anetareve te Organizates regjistrimin e ratifikimit te dyte qe do t'i komunikohet, Drejtori i pergjithshem do te terheqe vemendjen e Anetareve te Organizates mbi daten, ne te cilen kjo Konvente do te hyje ne fuqi.

#### Neni 15

Drejtori i pergjithshem i Zyres Nderkombetare te Punes do t'i komunikojte Sekretarit te pergjithshem te Kombeve te Bashkuara, per qellime regjistrimi, ne perputhje me nenin 102 te Kartes se Kombeve te Bashkuara, te dhenat e plota lidhur me te gjitha ratifikimet dhe te gjitha aktet e denoncimit qe ai do te kete regjistruar ne perputhje me nenet e mesiperme.

#### Neni 16

Sa here qe do ta gjykoje te nevojshme, Keshilli Administrativ i Zyres Nderkombetare te Punes do t'i paraqese Konferences se pergjithshme nje raport mbi zbatimin e kesaj Konvente dhe do te shqyrtoje nese duhet te regjistroje ne rendin e dites te Konferences ceshtjen e rishikimit te saj te pjesshem ose te plote.

#### Neni 17

1. Ne rastin kur Konferenca do te miratonte nje konvente te re qe ben rishikimin e plote apo te pjeseshme te kesaj Konvente dhe nese konvente e re nuk parashikon ndryshe:  
a) ratifikimi nga nje Anetar i Konventes se re qe ben rishikimin do te sillte, me plot te drejte, pavaresisht nga neni 13 me siperm, denoncimin e menjehershem te kesaj Konvente, me kusht qe konventa e re qe ben rishikimin te jete hyre ne fuqi.  
b) duke u nisur nga data e hyrjes ne fuqi te konventes se re qe ben rishikimin, kjo Konvente do te pushoje se qenuri e hapur per ratifikim nga Anetaret.  
2. Kjo Konvente do te mbetet, megjithate, ne fuqi ne formen dhe permbajtjen e saj per Anetaret qe do ta kishin ratifikuar dhe qe nuk do te ratifikonin konventen qe ben rishikimin.

#### Neni 18

Versionet ne frengjisht dhe anglisht te tekstit te kesaj konvente jane te barasvlefshrne.